

## GJUHA SHQIPE DHE RREZIKU NGA PËRKTHIMI

GENTJANA TARAJ

Universiteti i Vlorës, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Email: gtare@univlora.edu.al

### Përmbledhje.

Përkthimi letrar përfaqëson një segment të veçantë të përkthimit për shkak të vështirësive të shumta me të cilat sfidon përkthyesin letrar. Mendimi se njohja e një gjuhe të huaj është një kusht i mjaftueshëm për të përkthyer letërsi, ka çuar pas viteve 90-të në realizimin e përkthimeve jo korrekte dhe me pasoja për gjuhën shqipe. Qëllimi i këtij punimi është që përmes analizës së apekteve të ndryshme gjuhësore, të pranishme në përkthimin e veprave të Teodor Drajzerit e të tjerë, të dalë në përfundime në lidhje me rolin dhe ndikimin e përkthimit në gjuhën shqipe. Duke analizuar ndikimet morfo-sintaksore të anglishtes, kalkimet dhe huazimet e panevojshme në përkthim, si dhe aspektin drejtshkrimor në këto vepra, arrijmë në përfundimin se gjendja e përkthimit letrar në Shqipëri shtron nevojën për një ndërhyrje të menjëhershme, si rezultat i së cilës numri i përkthimeve do të rritet në raport të drejtë me cilësinë e realizimit të tyre. Kjo do ta kthente përkthimin letrar në një faktor zhvillues dhe jo frenues për gjuhën në të ardhmen. Punimi mbyllet me sugjerimin se politikat e shtetit shqiptar, veprimtaria e Akademisë së Shkencave, sikurse dhe roli i kritikës së përkthimit duhet të drejtohen nga ndërgjegjësimi i përkthyesve në lidhje me përgjegjësinë e dyfishtë që ata kanë, si dhe në gjetjen e formave për nxitjen jo vetëm të numrit të përkthimeve, por edhe të cilësisë së tyre.

**Fjalët kyç:** gjuha shqipe, letërsia e përkthyer, huazimet, gjuha burim, gjuha e përkthimit.

**Abstract.** Translation of literature seems to be the most challenging task to be performed by translators. Starting with a linguistic analysis the present articles examines the way cultural-specific items and syntactic structures are translated in three of Dreiser's novels. Furthermore, it attempts to reveal the great impact translated literature has on the target language, literature and culture. Finally, the discussion is restricted to problems encountered in these

translations. The article concludes that a special attention must be paid to translation of literature which contributes to the potential and richness of the Albanian language and literature.

**Key words:** albanian language, translated literature, borrowing, target language, source language.

**Hyrje.** Gjuha e letërsisë në dallim nga përdorimet e tjera të kodit shquhet për shfrytëzimin idiosinkretik të burimeve të tij duke u karakterizuar nga devijimeve të shumta gramatikore dhe semantikore. Sipas Widdowson, (1996) gjatë krijimit të një veprë letrare shkrimtari i thyen shpesh rregullat e kodit, si pasojë e të cilit kuptimi i gjuhës minimizohet. Këtë humbje ai nxiton ta kompensojë duke e vendosur njësinë në një modelim të ri, kuptimi i së cilit del nga lidhja me njësitë e tjera brenda kontekstit. Në këtë mënyrë, interpretimi i çdo teksti kërkon njohuri mbi dy marrëdhëniesh: së pari, njohja e lidhjeve "intra"-njësitë gjuhësore dhe kodit nga i cili kanë dalë (Widdowson, 1996:143) dhe së dyti, marrëdhëniet e jashtme "extra," midis njësive gjuhësore dhe kontekstit (Widdowson, 1996:144). Si rrjedhim, këto lloj marrëdhëniesh ndërtojnë një sistem gjuhësor të dytë, i cili kombinon funksionet e ndara të atyre që tradicionalisht do të dalloheshin si kod dhe kontekst, duke e shndërruar kështu gjuhën e letërsisë ndryshe nga përdorimet e tjera në tërësisht konotative.

Duke qenë se "gjuha është për shkrimtarin material në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës" (Wellek, R, Warren, A, 1993:163) analiza e suksesshme e një veprë letrare do të ishte praktikisht e pamundur pa njohuri të thella mbi gjuhën në përgjithësi dhe gjuhën e letërsisë në veçanti. Një rol thelbësor në identifikimin e tipareve stilistike luan ballafaqimi i sistemit gjuhsor të veprës letrare me përdorimin e zakonshëm të gjuhës në kohën, kur ajo u krijua. Në këtë kuptim, vepra letrare dëshmon mbi gjendjen në të cilën gjendet gjuha. Kjo është e vërtetë jo vetëm për veprën në origjinal, por edhe për përkthimin e saj pasi ashtu sikurse krijimi

fillestar edhe përkthimi është një proces, i cili pa gjuhën nuk do të ishte i mundur.

Në përpjekje për të krijuar efekte të barazvlefshme me origjinalin, përkthyesi shfrytëzon me mjeshtëri të gjithë kapacitetin shprehës, që gjuha e përkthimit i vë në dispozicion. Ndryshe nga shkrimtari, fantazia e të cilit endet e lirë, përkthyesi mbetet jo vetëm i varur nga hapësirat dhe kufijtë e vendosura prej imagjinatës së shkrimtarit, por edhe nga gjendja në të cilën gjendet gjuha me të cilën ai është duke punuar. Në rastin kur ajo është më pak e lëvruar dhe e shfrytëzuar sesa gjuha e origjinalit, problemet dhe vështirësitë me të cilat ai përballet janë të panumërta. Për të tejkaluar këto vështirësi përkthyesi vë në përdorim të gjitha aftësitë e tij krijuese duke gjeneruar dhe eksploruar forma të reja të shprehjes dhe stilit, si rezultat i së cilës ndodh pasurimi i gjuhës dhe letërsisë së përkthimit. Në këtë mënyrë, pohimi se letërsia ka fuqinë të kapërcejë kufijtë hapësinorë dhe kohorë duke krijuar efekte të njëjta në gjuhë me nivele të ndryshme, rezultojnë i vërtetë.

Si përfundim, pavarësisht faktorëve të tjerë ndikues, njohuritë që përkthyesi ka mbi të folurën e zakonshme, të folurën joletrare, apo të folurën e grupeve të ndryshme shoqërore të periudhës në të cilën jeton, janë ndër faktorët gjuhësorë që drejtojnë zgjedhjet e tij gjuhësore. Në këtë mënyrë, roli i përkthyesit letrar është i dyfishtë: nga njëra ana, vepra e përkthyer funksionon si një dokument i rëndësishëm i gjendjes së gjuhës me të cilën është shkruar dhe nga ana tjetër, përkthimi ndikon në zhvillimin e mëtejshëm jo vetëm të fondit letrar, shijeve estetike të lexuesit të gjuhës së përkthimit dhe perceptimin e realitetit nga ana e tij, por edhe në mënyrën sesi ata e përdorin gjuhën.

**Aspekte të analizës gjuhësore në përkthimin e veprave të Drajerit.** Pjesë e analizës janë përkthimet e shkrimtarit amerikan Teodor Drajer: "Një tragjedi amerikane," 1965, "Gjeniu," 1968 dhe Trilogjia e Dëshirave, 2004, të cilat qëndrojnë nga njëra-tjetra në një distancë kohore prej 40 vitesh. Nga analiza krahasuese e përkthimeve në fjalë, rezultojnë se përkthimet e para dhe pas viteve 90-të ndryshojnë, si në aspektin gjuhësor ashtu dhe atë funksional. Po t'i shtojmë kësaj dhe problemet aq të dukshme në përkthimin e romaneve të tjerë, arrijmë në përfundimin se tradita e përkthimit letrar në Shqipëri pas vitit 1990 e në vazhdim, paraqitet problematika në disa drejtime.

1-Një nga sfidat me të rëndësishme me të cilat përballet përkthyesi letrar është gjetja e fjalës, që i përgjigjet më mirë kuptimisht dhe stilistikisht fjalës përkatëse në origjinal, në mënyrë që të ruhen pasuritë

leksikore të gjuhës së përkthimit pa humbur dhe zbehur ngjyrimet e saj. Kjo kërkon nga përkthyesi njohjen e thellë të strukturave kuptimorë të fjalëve në të dyja gjuhët dhe pranimin e faktit se gjatë përkthimit ne ballafaqohemi me "sistemet leksiko-semantike dhe jo vetëm me fjalët" (Ymeri. E, 1990:109). Pra, zgjedhja e paraleleve leksikore duhet parë e lidhur ngushtë me respektimin e kontekstit, ku ato janë përdorur.

Në kuadrin e ballafaqimit të drejtpërdrejtë të mënyrave ligjërimore, në lidhje me të njëjtën situatë, do të shohim se si e njëjta njësi leksikore: "bird" dhe "fat", është përkthyer nga B. Doko përkatësisht me dy forma: "dreqi"- "njëri i rallë" dhe "trashaluaqi"- "bullafiqja" në varësi të kontekstit në të cilin janë shfaqur: " -*She's a bird that way-never gets enough- "Cfarë dreqi është ajo! "*, Well, you missed seeing a bird..."-*"Paske humbur rastin të shihje një njeri të rrallë. "*, "And the big fat guy...?"-*"Po ai trashaluaqi.."- "you and that fat girl, Piggy..."- "Ti dhe ajo bullafiqja, Pigin.."*(NJTA, fq, 45, 55) Një tjetër tipar i përkthyesit B.Doko është arritja e barazvlefshmërisë funksionale si përmes shfrytëzimit të vargjeve sinonimike të paraleleve leksikore të shqipes dhe anglishtes ashtu dhe kontekstit në të cilin ato janë përdorur, p.sh. folja "shout" është përkthyer përkatësisht si "bërtiti", "klithi", "gërthiti, thërriti, u çorr, sokëlliu" duke shmangur përseritjet e panevojshme, monotone dhe duke i dhënë ligjërimin të gjitha ngjyrat, që shfrimi i inatit dhe mërzi së një njeriu mund të marrë.

Në dallim me këtë qëndrim të kujdesshëm ndaj sinonimisë leksikore dhe pasurisë frazeologjike të shqipes, në përkthimin e trilogjisë vihet re fenomeni i përdorimit të panevojshëm të huazimeve nga anglishtja, të cilat jo vetëm e kanë fjalën përkatëse në shqip, por i kanë dhënë një tjetër ngjyrim origjinalit duke bërë që romanet e Drajerit të ngjajnë më tepër me një libër të fushës së biznesit sesa letërsi: *opsionin (mundësinë), konflikte (mosmarrveshje), qëndra afariste (qendra tregtare), konkluzione (përfundime), subkonshienca (nënvetëdija), apelim në gjykatën supreme (thirrje në gjykatën e lartë), bankënota (kartmonedhë), likujdoj mallin (shlyej, laj mallin), influencat (ndikoj), producent (regjizor), politikat lokale (politikat vendore), rezidenca (shtëpi banimi), etj.* Si rrjedhim, përdorimi i huazimeve mbi masën e lejuar, e ka shndërruar leximin e romanit në një veprimtari të lodhshme, lehtësimi i të cilit do të kërkonte përdorimin e një fjalori shpjegues.

2- Analiza e kujdesshme e strukturave sintaksore të origjinalit i shërben përkthyesit për të zbuluar mënyrën sesi shkrimtari e strukturon realitetin. Gjithashtu, kjo analizë shërben për të ndërtuar strategjitë e nevojshme të cilat brenda kufijve të tolerancës

gjuhësore përzgjedhjen në gjuhën e përkthimit strukturat sintaksore funksionalisht të barazvlefshme me origjinalin. P.sh. nëpërmjet modulimit dhe transpozimit M. Bobrati i shkrin dy fjalitë e mëposhtme në një duke ruajtur funksionin pragmatik të origjinalit dhe zhdërvjelltësinë e gjuhës shqipe “ *It was his attitude toward life. His craze about the beautiful, particular in women*”-“*Jo, jo e keqja ishte te Juxhini, te qëndrimi i tij në jetë, marrëzia e tij për të bukurën.*” (Gjeniu, 578). Po përmes modulimit, transpozimit dhe shmangies vijnë natyrshëm në gjuhën shqipe dhe të paprekura si aspekti semantik dhe funksionaliteti pragmatik i origjinalit: “*He thought and thought, but he came back to the same conclusion always. He would have to marry her. There was no way out. He would have to*”-“*Vazhdonte ta vriste mendjen me këtë çështje për shumë kohë, por prapë kthehej në të njëjtin përfundim: duhej të martohej me të! S’kishte rrugë tjetër.*” (Gjeniu, 578)

Sidoqoftë, jo rallë herë ndodh që në përkthimet tona të vihen re ndikime të dukshme të sintaksës së origjinalit, që bien në kundërshtim me natyrën e shqipes dhe dëmtojnë natyrshmërinë dhe rrjedhshmërinë e saj: “*Sjellja e saj, ndonëse e panatyrshme për një bijë, por ishte plotësisht e shpjegueshme për dhimbjet shpirtërore që përjetonte i dashuri...Nuk e kuptoj-tha Molenhauri-veçse po e detyruam Stinerin që t’i kthejë paratë sërish në arkë, përpara se të falimentojë Kauperudi, se si do t’i heqim qafe telashet e mëdha që do të lindin më pas...Por, pas një fare kohe, ndërsa rritej e rritej ende më shumë afërsia e tij me Ejlinin, atë nisi të mos e shqetësojë mendimi, nëse dyshonte apo jo e shoqja...Pavarësisht dyshimeve që i zenin, .....Batleri nuk mund të mos e admironte guximin e saj, çfarë pamje sfiduese kishte!* (Monedhë Dashurie, 2004, fq. 605, 251, 197, 281)

3-Një tjetër fenomen shqetësues në përkthimin letrar të viteve të fundit është dhe drejtshkrimi. Në dallim me botimet e para viteve 90-të, ku çdo libër i botuar kalonte më parë në duart e korrektorit teknik dhe redaktorit duket sikur viteve të fundit askush nuk e kryen më një funksion të tillë: *inisiative-duhet-iniciative, i fanepseshim koncepte-i faniteshin koncepte, filigrane argjendi-filigrane argjendi-pejsazh-peisazh, pushë i dendur i kadiftë-push i dendur, i kadifenjtë, ai do t’a shpërblente-ai do ta shpërblente, vogëloshë-vogëlushe, planizante-planifikoj, lagja, lagjja, etj.* (Monedhë Dashurie, Stoiku).

4- Shpesh vështirësitë e përkthimit letrar nuk lidhen thjesht me fjalorin apo sintaksën e gjuhëve, sesa me elementët e lidhura me kulturën. Një nga mënyrat sesi përkthyesi arrin të kompensojë mungesën e njohurive të lexuesit të gjuhës së përkthimit në lidhje me

elementët kulturor të origjinalit, është dhe përdorimi i “footnote” apo shpjegimeve në fund të faqes. Duke qenë se karakteristikë e stilit të Drajzerit është përdorimi i aludimeve qofshin këto letrare, kulturore, biblike apo klasike shpjegimi i tyre për lexuesin e gjuhës së përkthimit është shpesh herë i domosdoshëm. Në romanin “Gjeniu” numërohen 53 përdorime të tilla, të cilat përfshijnë që nga shpjegimet e njësive matëse si p.sh. të gjatësisë, sipërfaqes, parasë, peshës, etj e deri tek ato që lidhen me aludimet letrare nga veprat e Shekspirit, filozofëve të ndryshëm, mitologjia, etj.

Në përkthimin e trilogjisë hasen pak raste të përdorimit të shpjegimeve në fund të faqes. Për mendimin tonë, kjo për dy arsye: së pari, lehtësia në gjetjen e informacionit ka ndikuar pozitivisht në thellimin e njohurive të lexuesit shqiptar mbi kulturat e tjera. Si rrjedhim, përkthyesi beson se lexuesit nuk i duhet ndërhyrja e tij për të kuptuar aludimet e shkrimtarit. Së dyti, përkthyesit vetë i mungojnë njohuritë mbi kulturën nga e cila përkthen dhe i shmanget përgjegjësisë duke i lënë fjalët jo vetëm pa shpjegim, por edhe të paqarta përsa i takon kuptimit të tyre. P.sh.: *katr-premje, a la Shantekler, stërlina, Çoser, Circe, shpirtrat e Hekatës, krupesë, etj.* (Stoiku, Titani)

**Përfundime.** Në përpjekje për të krijuar efekte të barazvlefshme me origjinalin duke i qëndruar besnik jo vetëm kuptimit por edhe stilit të tij, përkthyesi përpigjet të shfrytëzojë të gjitha burimet shprehëse të gjuhës së përkthimit si dhe të krijojë forma të reja të shprehjes. Duke qenë se gjuha është për veprën material me të cilën ajo ndërtohet, studimi i saj do të ishte studim i gjendjes së gjuhës në kohën, kur vepra u shkrua apo u përkthye.

Nga krahasimi gjuhësor i përkthimeve të Drajzerit para dhe pas viteve 90-të, vihet re se ndërsa dy përkthimet e para 90-ës paraqesin interes përsa i takon mënyrës së shfrytëzimit të pasurisë shprehëse të gjuhës shqipe (frazologjisë, vargut sinonimik, strukturave sintaksore, etj) përkthimet e pas viteve 90-të, pavarësisht vlerave të pamohueshme mbeteten të kritikueshme në disa aspekte, si p.sh. huazimet e panevojshme, imitimi i strukturave sintaksore të origjinalit, pakujdesia ndaj drejtshkrimit në gjuhën shqipe.

**Arsyet:** Para viteve 90-të mësimi i gjuhës shqipe në shkolla realizohej me seriozitet dhe përgjegjshmëri. Procesi i ruajtjes së gjuhës shqipe ishte në qendër të vëmendjes së shtetit dhe të gjitha instancave përkatëse. Përkthimi ecte në gjurmët e traditës së krijuar ndër vite duke u kthyer në një shkollë të vërtetë. Akademia e Shkencës tregonte kujdes

kundrejt të gjitha rasteve të divijimeve apo shmangieve nga norma. Kontakti i pakët me gjuhët e huaja shmangte rastet e depërtimit të elementëve të huaj gjuhësor në gjuhën shqipe.

**Zgjidhja:** Rritja e përgjegjësisë për të mbrojtur gjuhën shqipe si pjesë të ekzistencës së kombit shqiptar. Rritja e cilësisë së mësimdhënies në shkolla, mbrojtja e gjuhës shqipe përmes sanksioneve ligjore. Penalizimi i shtëpive botuese dhe përkthyesve për çdo rast të shkeljes së normës gjuhësore. Kritika përkthimore duhet të ushtojë ndikimin e saj pozitiv mbi rritjen e cilësisë së përkthimit dhe pasurimin e mëtejshëm të letërsisë shqiptare me forma dhe stile të reja.

**Referenca:**

WEBBER, Jean Jacques (1996), *The stylistic reader: from Roman Jakobson to the present*, Bristol.W.Arrowsmith Ltd, Widdowson, H.G, Stylistics: An approach to stylistic analysis.

WELLEK, R, WARREN (1956, 1993), *A Theory of Literature*, Harcourt Brace&Company (përkthyer në shqip nga Xhevat Lloshi, *Teoria e Letërsisë*, Tiranë).

YMERI, Eshref (1990), »Probleme të zgjedhjes së barazvlerësve leksikorë«, "*Studime Filologjike*", Tiranë, nr. 2.